

Bashkia: DEVOLL

Kryetar: BLEDJON NALLBATI

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Preftime:

1. Do të hartohet masterplani urbanistik afatgjatë për të gjithë zonën e Devollit, në të cilën do të integrohen të 45 qendrat e banuara, të harmonizuara me njëra-tjetrën konform të gjitha normave europiane të funksionalitetit dhe bashkëjetesës
2. Do të rehabilitohen rrjetet e infrastrukturës publike me përparësi furnizimin me ujë të bollshëm dhe të shëndetshëm për të gjithë popullatën
3. Do të përmirësohet dhe zgjerohet infrastruktura rrugore që lidh fshatrat, por edhe rrugët e lagjeve, në fshat e qytet
4. Do të rehabilitohet sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza e të bardha, pastrimi sistematik, grumbullimi dhe përpunimi i plehrave, të mbetjeve humane dhe stallore në territorin e bashkisë
5. Do të ndërtohen ambiente çlodhëse rekreative për të gjithë qytetarët, moshën e tretë, fëmijët dhe të rinjtë në territorin e bashkisë
6. Do të ndërtohen qendra shëndetësore në çdo fshat dhe lagje të qytetit
7. Do të rehabilitohet qendra e qytetit, për ti dhënë pamjen e një qendre bashkëkohore
8. Do të rehabilitohen rrugët kryesore dhe të lagjeve në Bilisht, shenjimi i tyre me emrat përkatës dhe me sinjalistikë, gjithashtu sistemi i parkimit të automjeteve
9. Do të finalizohet projekti për kanalizimin e ujërave të zeza në Bilisht
10. Do të realizohet studimi për rehabilitimin e shtratit të lumit Devoll për ta shndërruar atë në një park të madh, në një qendër të madhe çlodhëse, argëtuese dhe rekreative
11. Do të rehabilitohen dhe unifikohen fasadat e pallateve në Bilisht
12. Do të ndërtohen 1-2 mbikalime në të dy anët e autostradës

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Preftime:

1. Do të ndërtohen dhe rehabilitohen shkollat, ambientet sportive dhe gjithashtu do të ndërtohen qendra shëndetësore e kulturore në çdo fshat dhe lagje të qytetit
2. Do të trefishohet buxheti i Bashkisë për kulturën e sportet për të shtuar gamën e aktiviteteve kulturore dhe sportive me synim ngritjen e një trupe teatrore, ansamblin e këngës dhe valles devolliçe sipas grup-moshave
3. Do të financohet ngritja e ekipeve zinxhir jo vetëm në futboll, por edhe sporte të tjera

4. Do të ndërtohet çerdhe e re në Bilisht
5. Do të ndërtohet një Pallat Kulture me bibliotekë, kinema dhe teatër, me ambiente për të gjitha moshat në Bilisht

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Preftime:

1. Do të hartohet guida turistike e Devollit
2. Do të nxiten projekte konkrete e ulje të taksave e tatimeve e me lehtësimin e lejeve të ndërtimit të turizmit malor e atë liqeno-lumor, turizmin historik e kulturor dhe do të përmirësohet e zhvillohet infrastruktura përkatëse për ti shndërruar këto në qendra pelegrinazhi turistik
3. Do të merren në mbrojtje, restaurohen dhe rehabilitohen monumente, si: Shpella e Trenit, Pikturat e Spllesë dhe Gurët- mumje të Trenit, Kalaja e Trojanit, Kalaja e Bilishtit, Burimet e Progrit, Guri i Ariut, Ahishtja e Shën Kostandinit, Pylli i Shën Thanasit, Dushkaja e Dobërgorë, Ahishtja e Bradvicës, Bredhi i Vishjes dhe Gurët e Buallit në Kurlë
4. Do të merren masa konkrete për shtimin, mbarështimin dhe mbrojtjen e pyjeve komunalë dhe shfrytëzimin me kriter të tyre
5. Do të shtohen sipërfaqet e gjelbëra në rrugët kryesore dhe në lagje në Bilisht

Fusha: BUJQËSI

Preftime:

1. Do të sigurohet dhe garantohet tregu i shitjes së prodhimeve përmes ngritjes së magazinave dhe trefishimin e kapaciteteve frigoriferike, ngritjen e punishteve agro-përpunuese sa më afër vend-prodhimit, por edhe në Bilisht
2. Do të realizohet zhvillimi intensiv dhe ekstensiv i blegtorisë, rregullimi e përmirësimi i strukturës ranore dhe të llojeve të gjësë së gjallë dhe rritja e kontrollit sanitaro- veterinar
3. Do të krijohen hapësira dhe mundësi që do të ndihmojnë sektorin e produkteve bujqësore që kërkohen nga tregjet kombëtare, rajonale dhe më gjerë
4. Do të zhvillohet me përparësi frutikultura, kultivimi i arrorëve, farorëve dhe bimëve medicinale duke nxitur me projekte konkrete kreditimin me kushte lehtësuese, dhënie e granteve etj
5. Do të realizohet rehabilitimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit të tokës, me synim për të ujitur 100% të sipërfaqes
6. Do të rritet në një shkallë të re shërbimi i këshillimit e prognozë- sinjalizimit
7. Do të ullet çmimi i karburantit për punimet bujqësore, të çmimit të imputeve bujqësore e kontrollit të standarteve të tyre përmes subvencionit të një pjese të kostos së tyre
8. Do të ndërhyet me masa efektive për rehabilitimin dhe shfrytëzimin racional e me efikasitet të kullotave

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Do të aplikohet dhënia e ndihmës ekonomike dhe financiare për familjet në nevojë
2. Do të ndihmohen dhe lehtësohet integrimi i emigrantëve të kthyer: kryesisht të fëmijëve të tyre për arsimim dhe shkollim; politika lehtësuese me ulje të taksavedhe tarifave për bizneset e tyre; lehtësim në dhënien e lejeve të ndërtimit për strehim e biznese
3. Do të ndihmohen, përmes politikave afatgjata, punësimi i romëve dhe shtresave në nevojë, integrimin e tyre të plotë në shoqëri dhe shkollimi e strehimi i tyre

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Do të ndiqen politika nxitëse e lehtësuese përmes uljes së barrës fiskale, përsheptimit të dhënies së lejeve të ndërtimit, përpilimit të programeve afatgjata në ndihmë të biznesit
2. Do të hapen dhe krijohen vende të reja pune nëpërmjet rritjes së investimeve, stimulimit të biznesit, punëve publike dhe shërbimeve publike
3. Do të nxitet dhe stimulohet zhvillimi i fasonëve, kryesisht në qytetin e Bilishtit, bizneset agro-përpunuese dhe bizneset turistike në të gjithë territorin e Devollit